

Prof. Dr. Skender TOPI takim në Senatin e Republikës Italiane



Marrëveshje e rëndësishme midis Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" dhe Qendrës Ndërkombëtare të Studimeve Ekonomike për Fondet Evropiane.

Më datë 6 Prill 2023 në Senatin e Republikës në Itali, u mbajt Konferenca e Parë Ndërkombëtare për Fondet Evropiane, ku morën pjesë aktorë shkencorë nga Amerika e Veriut dhe aktorë shkencorë nga Zona Euromesdhetare.

Në këtë takim të rëndësishëm, Rektori i Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", Prof.dr. Skender Topi, nënshkroi marrëveshjen strategjike të bashkëpunimit me Presidentin e Qendrës Ndërkombëtare të Studimeve Ekonomike për Fondet e BE-së, Prof. Santi Tomaselli, me Prof. Michele Vincenti i Universitetit Perëndimor të Kanadasë, si dhe Përfaqësuesin e Punëve të Jashtme dhe Biznesit të Egjiptit Prof. Basem Ibrahim.

Në fjalën e tij përshëndetëse Prof. Skender Topi u shpreh:

"Jam i kënaqur, sepse kjo marrëveshje e nënshkruar në një nga godinat më të rëndësishme të institucioneve italiane si Senati i Republikës, shënon një arritje për Universitetin e Elbasanit në fushën e bashkëpunimit shkencor të Fondeve Evropiane.



Nënshkruhet marrëveshja e bashkëpunimit midis UE dhe ILD

Sot u nënshkrua Marrëveshja e bashkëpunimit nga Rektori i Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", Prof.dr. Skender Topi dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani, me qëllim bashkëpunimi në thellimin dhe shkëmbimin e njohurive në fushën e drejtësisë, duke ndërmarrë veprimtari me interes të përbashkët. Në vijim, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, mbajti një leksion të hapur me studentë e personelin akademik të Departamentit të Drejtësisë me temë "Roli i ILD-së në arkitekturën e re të sistemit të drejtësisë"

Zëvendësiministrja e Ministrisë së Drejtësisë në UE



Në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" u zhvillua një leksion i hapur nga zëvendësiministrja e Ministrisë së Drejtësisë dhe zëvendëskryenegociatorja Znj. Adea Pirdeni Znj. Pirdeni, prezantoi për studentët rreth ecurisë së negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian - Kapitulli 23 "Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore", rëndësinë e këtij procesi për qytetarët në tërësi, juristët, studentët të historisë dhe gazetarisë. Zëvendësrektorja e Universitetit, Prof.as.dr. Elvira Fetahu, në fjalën e saj përshëndetëse, shprehu rëndësinë e funksionimit të drejtësisë për garantimin e një shoqërie të drejtë dhe të barabartë, si dhe rolin e studentit në mbështetjen dhe përmirësimin e sistemit të drejtësisë në vendin tonë.

Konferencë Kombëtare



Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", mori pjesë në Konferencën Kombëtare me temë "Bashkëpunimi Universitet-Biznes, një nga shtyllat e modernizimit të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor", organizuar nga AKKSHI dhe MAS. Universiteti i Elbasanit, është fitues i disa projekteve të financuara nga AKKSHI dhe në këtë konferencë u prezantua në panelin e diskutimit nga zëvendësrektorja e universitetit, Prof.as.dr. Elvira Fetahu me një projekt kërkimor-shkencor.

Konferenca e Rektorëve



Më datë 20 Prill 2023, u zhvillua takimi i radhës i Konferencës së Rektorëve të Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri.

Gjatë këtij takimi u diskutuan disa nga çështjet më të rëndësishme me interes të përbashkët për Institucionet e Arsimit të Lartë në vend si :

Komunikimi i vazhdueshme me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, për ndërmarrjen e disa nismave ligjore prej saj, si zhvillimin e programeve të studimit në distancë, përcaktimi i nivelit të kompetencës së njourive në gjuhën e huaj, për kandidatët që do të zhvillojnë studimet e ciklit të tretë Doktoratë dhe atyre specializim;

Koordinimi i politikave të përbashkëta dhe dakordësia për arritjen e një marrëveshjeje ndërmjet Republikës së Qipros, Greqisë dhe Shqipërisë në kuadër të zhvillimeve evropiane të Arsimit të Lartë me interes për palët pjesëmarrëse, e më gjerë;

Miratimi në parim i projektstrategjisë për një universitet miqësor ndaj mjedisit.

Anëtarët e Konferencës së Rektorëve rikonfirmuan me miratim unanim, kryesinë e kësaj Konference, duke rizgjedhur kryetarin aktual, Prof. Dr. Artan Hoxha dhe 2 (dy) nënkryetarët, Prof. Dr. Skender Topi dhe Prof. Dr. Tonin Gjuraj.

Në përfundim të takimit, Kryetari i Konferencës së Rektorëve u kërkoi anëtarëve të konferencës, njoftimin e të gjithë studentëve e IAL-ve publike dhe jo publike për pjesëmarrje në Konferencën Ndërkombëtare Studentore, në datat 18-19 Maj 2023.



Java Ndërkombëtare, Krakov, Poloni

Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" mori pjesë në Javën Ndërkombëtare, të organizuar nga Universiteti i Ekonomikut, Krakov, Poloni. Në kuadër të aktiviteteve, u zhvillua edhe takimi zyrtar midis Zëvendësrektorës së Universitetit të Elbasanit Prof.as.dr. Elvira Fetahu dhe Prof.dr hab Paweł Lula, Zëvendësrektor i Universitetit të Ekonomikut. Në këtë takim, u diskutua për bashkëpunimin e suksesshëm disavjeçar ndërmjet dy institucioneve dhe mundësitë e zgjerimit të këtij bashkëpunimi në të ardhmen.

Leksion i hapur në FSHMT



Në kuadër të marrëveshjes me Universitetin e "Tampere University of Applied Science" Finlandë, Departamenti i Infermieristikës në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, zhvilloi leksionin e hapur me temë "Genomics, The future of Nursing" si fjala e fundit dhe sfida aktuale e infermieristikës. Leksionet u mbajtën nga Prof. Arja Halkoaho, aktualisht Principal Lecturer dhe lidere e "Genetic and Genomic Nursing Education - GenoNurse", si edhe Senior Lecturer, Msc/PhD Cand. Mari Laaksonen. Leksioni u ndoq me mjaft interes nga personeli akademik dhe studentët e këtij fakulteti.

Olimpiada e Kangurit të matematikës



Matematika është gjuha të cilën e flasin shkencat ekzakte si dhe jeta jonë e përditshme. Nxitja e dëshirës për të mësuar matematikë është prioritet i punës tonë të përditshme. Ditën e shtunë, nën mbikqyrjen e Departamentit të Matematikës, u zhvillua në ambientet e Universitetit të Elbasanit Olimpiada e Kangurit të matematikës.



Simpozium Shkencor në FSHMT

Në ambientet e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike është zhvilluar Simpoziumi Shkencor "Ndikimi i COVID-19 në organizimin dhe menaxhimin e sistemit shëndetësor, implementimi i një modeli epidemiologjik matematikor". Ky aktivitet shënoi përmbylljen me sukses të projektit të parë të fituar nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike në bashkëpunim me Departamentin e Matematikës, falë bashkëpunimit të vazhdueshëm me Agjencinë e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit. Zëvendësrektorja e Universitetit, Prof.as.dr. Elvira Fetahu, në fjalën e saj përshëndetëse, shprehu rëndësinë e këtij simpoziumi në ridimensionimin e kërkimit shkencor në kuadër të programeve kombëtare të financuar nga AKKSHI, në të cilat Universiteti i Elbasanit numëron me sukses një pjesëmarrje të kënaqshme dhe rezultate të prekshme.

Bordi Këshillimor i Biznesit



Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", zhvilloi takimin e parë në kuadër të Bordit Këshillimor të Biznesit në bashkëpunim me Sektorin e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni. Përfaqësues të Elite Travel Group zhvilluan me studentë të programeve të ndryshme të studimit një takim me qëllim informimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit të tyre, për rëndësinë dhe potencialin e turizmit në vendin tonë, si dhe mundësitë që ofron ky sektor për krijimin e vendeve të reja të punës. Gjithashtu u theksua nevoja për orientimin e studentëve në këtë sektor për t'u dhënë atyre mundësinë që të qendrojnë dhe të investojnë në zhvillimin e tyre dhe të vendit. Universiteti i Elbasanit prej vitesh ka lidhur marrëveshje me bizneset më prestigjioze të Qarkut të Elbasanit, për t'u ardhur në ndihmë studentëve me workshope, trajnime, projekte apo mundësi punësimi.

Promovim libri



Në kuadrin e veprimtarive të Fakultetit të Shkencave Humane dhe me mbështetjen e Rektoratit të UE-së, Departamenti i Letërsisë dhe Gazetarisë në bashkëpunim me Departamentin e Gjuhësisë, organizuan sot në mjediset e Bibliotekës së UE-së, promovimin e librit "William Shakespeare" të Victor Hugo, përkthyer nga Abdulla Rami dhe Ermira Xhomaqi - Godo. Të pranishëm ishin pedagogë dhe studentë të të dyja departamenteve, nxënës të gjimnazit "Dhaskal Todri", të cilët shprehën mendimet dhe vlerësimet e tyre për këtë vepër, si edhe diskutuan rreth vlerave dhe risive të saj në letrat shqipe. Përkthyesja e librit, zj. Ermira Xhomaqi - Godo, pasqyroi rrugëtimin e gjatë dhe punën përkushtuese prej disa dekadash, për ta sjellë në shqip këtë vepër "sui generis" dhe me vlera shumëdimensionale për lexuesin shqiptar.